



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D' Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
[ëë.avokatipopullit.gov.al](http://ee.avokatipopullit.gov.al)

Tiranë ____/____2018

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE

NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT

CIVIL NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE

Në zbatim të nenit 26 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe të Kreut II, dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr, 242, datë 18.3.2015 "Për Plotësimin e Vendeve të Lira në Kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese", Institucioni i Avokatit të Popullit shpall procedurat e Lëvizjes Paralele, Ngritjes në Detyrë dhe Pranimi nga Jashtë në Shërbimin Civil, në pozicionin:

1 (Një) Nd/Komisioner të Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër Çnjerëzor ose Poshtëruës, Kategoria e pagës II-b

Pozicioni i mësipërm ju afrohet nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për Procedurën e Lëvizjes Paralele.

Vetëm në rast se në përfundim të Procedurës të Lëvizjes Paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, atëherë ky pozicion është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet Procedurës të Ngritjes në Detyrë.

Data e fundit e dorëzimit të dokumentave për procedurën e Lëvizjes Paralele është 16 07.2018. Ndërsa për procedurën e Ngritjes në Detyrë dhe Pranimi nga Jashtë Shërbimit Civil është 23.07.2018.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Nd/Komisioner në Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër Çnjerëzor ose Poshtëruës;

- Kryen inspektive periodike rutinë dhe tematike në institucionet e privimit të lirisë me fokus parandalimin e dhunës, trajtimit çnjerëzor, degradues dhe torturës si pjesë e grupit shumë-disiplinor të Mekanizmit për Parandalimin e Torturës.

- Ndjek rastet që paraqiten nëpërmjet ankesave të personave të shoqëruar/arrestuar/ndaluar, si dhe të burgosur/paraburgosur, apo edhe familjarëve të tyre, apo edhe organizateve vendase apo të huaja.

- Kryen inspektive pranë institucioneve të privimit të ligjshëm të lirisë së individit kur ka sinjalizime/njoftime për shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

- Harton, si pjesë e grupit shumë - disiplinor të Njësisë, rekomandime për çështje të veçanta apo edhe rekomandime legjislative në rastet kur vete ligji apo akti nënligjor gjykohet se përbën premisë për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me fokus parandalimin e dhunës, trajtimit çnjerëzor, degradues dhe torturës.

- Prgatit informacione për raportet periodike të monitorimit të mekanizmave të ndryshme ndërkombëtare me fokus parandalimin e dhunës, trajtimit çnjerëzor, degradues dhe torturës në institucionet e privimit të ligjshëm lirisë, si pjesë e grupit shumë-disiplinor të Njësisë.

- Merr pjesë në grupe te punës për hartimin e raporteve të veçanta dhe ndjekjen në vijim të rekomandimeve të dala prej tyre.

- Ushtron çdo kompetencë tjetër që i jepet nga Drejtuesi i Mekanizmit dhe /apo titullari i institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Është aktiv në median visive dhe të shkruar me intervista apo edhe emisione të drejtpërdrejta mbi problematika të caktuara.

I-Lëvizja Paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunës civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

1. Kushtet për Lëvizjen Paralele dhe kriteret e vecanta për pozicionin Nd/Komisioner në Mekanizmin për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër Çnjerëzor ose Poshtëruës.

Kandidatët për Lëvizjen Paralele duhet të plotësojnë kushtet si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (Kategoria II-b)

- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokumnt nga institucioni)

- Të ketë të paktën një vlerësim shumë mirë ose mirë.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë Diplomë të nivelit "Master Shkencor", në shkencat sociale, dega Psikologji Edhe diploma e nivelit "Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- Të zotërojë gjuhën angleze.
- Të ketë përvojë pune të paktën mbi 4 vjet në administratën publike, si dhe të paktën 2 vjet në nivel të barazvlefshëm me atë të mesëm drejtues.
- Përvoja e punës në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut përbën avantazh.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve ose Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit, si më poshtë vijon:

- Letër motivimi për aplikim për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-maili.
- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

- Fotokopje e Diplomës
- Fotokopje e Librezës së Punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
- Fotokopje të Letërnjoftimit (ID)
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentat e përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejt në institucion e Avokatit të Popullit brenda datës 16.07.2018.

3.Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën 18 07.2018, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e

përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Lëvizjes Paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik.

Në të njëjtën datë do të njoftohen kandidatët, që nuk plotësojnë kërkesat e Lëvizjes Paralele të përcaktuara në shpalljen për konkurim, renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk publikohet dhe administrohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve e cila njofton në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të ankesës.

4. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin Nd/Komisioner në Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër Çnjerëzor ose Poshtëruës, do të vlerësohen në lidhje me:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (ligji nr.76/2016)
2. Ligji nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar
3. Kodi i Procedurave Administrative (ligji nr.44/2015)
4. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
5. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.
6. Konventa dhe Aktet Ndërkombëtare për Parandalimin e Torturës Trajtimit jo Human dhe Degradues.
7. Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës
8. Ligji nr.45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentat e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”
9. Ligji nr.44,20123 “për Shëndetin Mendor”
10. Ligji nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”

11. Ligji nr.10087, datë 26.2.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”, të ndryshuar.
12. Ligji nr.51/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10107, datë 30.3.2009 “Për Kujdesin Shëndetësor ne Republikën e Shqipërisë”.
13. Ligji nr.91 datë 17.07.2003 “Për Shëndetin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”
14. Ligji nr.10138 datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”.
15. Ligji nr.10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”
16. Ligji nr.152/2013 “Për Statusin e Nënpunësit Civil”, i ndryshuar.
17. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit”
18. Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet positive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me :

Njohuritë, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e punës;
Eksperiencat e tyre të mëparshme;
Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzumin nr.4, datë 13.08.2014, të Departamentit të Administratës Publike:

www.dap.gov.alhttp:dap.gov.al/vende-vakant/udhezime-dokumenta

6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikut pranë

Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042380334 ose në adresën: Avokati i Popullit, Bulevardi "Zhan' Dark" nr.2, Tiranë.

II. Ngritja në Detyrë

Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në këtë shpallje, në përfundim të Procedurës së Lëvizjes Paralele, rezulton se është ende vakant, atëherë ky pozicion është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet Procedurës së Ngritjes në Detyrë dhe Pranimit nga Jashtë Shërbimit Civil.

Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit, duke filluar nga data 27.07.2018.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nënpunës civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për Ngritjen në Detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin vakant.

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët për Procedurën e Ngritjes në Detyrë janë:

- Të jetë nënpunës civil i konfirmuar;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga Institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësim shumë mirë ose mirë;
- Të ketë të paktën 2 vjet përvojë pune në kategorinë e pagës III-a ose III-a/1
- Niveli i Diplomës duhet të jetë "Master Shkencor". Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.

Kandidatët për pozicionin Psikolog (Nd/Komisioner), në Mekanizmin për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër Çnjerëzor ose Poshtëruës, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë Diplomë të nivelit "Master Shkencor", në shkencat sociale (Psikologji). Edhe Diploma në nivelin "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- Të ketë njohuri të thella të gjuhës angleze ose një gjuhë tjetër të vendeve të BE-së.
- Të ketë përvojë pune të paktën mbi 4 vjet në administratën publike.

- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

- Të gjithë kandidatët që aplikojnë për vendin vakant të sipër-përmendur duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a. Letër motivimi për aplikim për vendin vakant të punës, një numër kontakti, adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-maili për komunikim.

b. Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakan/udhezime-dokumenta/2019-udhezime-dokumenta>

c. Fotokopje të Diplomës

ç Fotokopje të Librezës së Punës

d. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër me postë apo dorazi deri në datën 23.07.2018, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve apo në zyrën e Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Mënyra e vlerësimit të Kandidatëve.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a- Vlerësimi me shkrim deri në 40 pikë

b. Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë

c. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar, i gjeni në Udhëzimin nr.2 datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike në adresën:

www.dap.gov.al

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-datë-27-03-2015>

III-PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të Procedurës së Lëvizjes Paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së Pranimit në Shërbimin Civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Institucionit të Avokatit të Popullit, duke filluar nga data 27.07.2018

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe kriteret e vecanta

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të Shërbimit Civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje.
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga Shërbimi Civil, që nuk është shuar sipas Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor”, në shkencat sociale (Psikologji). Edhe Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- Të ketë përvojë pune të paktën mbi 4 vjet në administratën publike.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

2. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë vijon:

- a. Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standart>

- b. Fotokopje e Diplomës (përfshirë edhe Diplomën Bachelor);
- c. Fotokopje e Librezës së Punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.;
- e. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të gjendjes shëndetësore
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit, brenda dates 23.07.2018.

Mënyra e vlerësimit të Kandidatëve është e njëjtë si për Procedurën e Ngritjes në Detyrë

Data e Daljes së Rezultateve të Konkurimit dhe Mënyra e Komunikimit

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për Procedurën e Ngritjes në Detyrë dhe atë të Pranimit në Shërbimin Civil do të marrin informacion në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure.:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- Vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- Mënyrën e Vlerësimit të kandidatëve

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Populli duke filluar nga data 27.07.2018.